



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 607/1 prot.

Tiranë, më 09. 06. 2023

V E N D I M

Nr. 81, datë 09. 06. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 79, datë 17.05.2023, e A. J., ku pretendohet diskriminim, *për shkak të aftësisë së kufizuar*, nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Tiranë².

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri³,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Ankuesi parashtron ndër të tjera se: *“...gjatë jetës sime kam punuar me dinjitet dhe ndershmëri. Puna për mua ka qenë një vlerë absolute dhe nuk kam refuzuar asnjëherë asnjë variant pune. Siç thashë edhe me parë puna për mua është një e drejtë themelore e njeriut që unë gjithnjë kam respektuar.*

Profili i punëve që kam kryer përgjatë gjithë jetës sime mund të evidentohet me atë që gjerësisht përkufizohet si punë të rënda. Ndërtim, hamall, punëtor krahu, por gjithmonë aktiv dhe kontribues në shoqëri...

Sot në moshën 61 vjeçare për shkak edhe të punëve që kam kryer përgjatë gjithë jetës, po përballim me një problem të rëndë fizik që pamundëson përfshirjen time në tregun e punës. Në këto kushte, duke pasur përsëri dinjitetin njerëzor si udhërrëfyes, unë ju drejtova institucioneve

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMCAPI Tiranë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

shtetërore me besim dhe i bindur se, një shtet i së drejtës mbrohet personat në nevojë. Unë jam një person në nevojë dhe besoj se meritoj një jetë dinjitoze, tani që për arsye objektive dhe lehtësisht të provueshme unë nuk mund të jem pjesë e tregut të punës.

Për këtë arsye ju drejtova KMCAP të zonës sime (tek Iraniani, Bryli) që të futem në skemën e mbrojtjes sociale dhe të përfitoj pagesën e aftësisë së kufizuar në përputhje me ligjin. Përgjigja që mu dha nga përgjegjësit atje ishte se unë “nuk përfitoja nga skema e mbrojtjes sociale, duke qenë se për afro 30 vjet kisha derdhur kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore”. Si argument për këtë përgjigje ishte VKM nr. 722, dt. 11.11.2022.

Në këto kushte ju drejtova Institutit të Sigurimeve Shoqërore me bindjen se po kërkoj atë që më takon. Përgjigja e përgjegjësve të këtij institucioni ishte se “Nuk përfitoj nga skema e sigurimeve shoqërore, pasi nuk kam asnjë vit të siguruar në 5 vitet e fundit.”

...ngërçi i krijuar me rastin tim, por edhe me shumë si unë nuk është krijuar nga asgjë tjetër përveç interpretimit sipërfaqësor të VKM nr. 722, dt. 11.11.2022 nga ana e punonjësve të institucioneve përgjegjëse. Kjo sepse VKM në fjalë në kreun 2, pika 1, germa d) përcakton se: “personi duhet të jetë i paaftë për punë dhe të mos plotësojë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës, sipas ligjit të Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu e njëjta VKM në kreun 2, pika 1, germa dh), përcakton se: “personit duhet të mos i ketë lindur e drejta për përfitim të pensionit të pleqërisë/social sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Isha i bindur se kuadri ligjor ishte i qartë dhe shkova për të kërkuar të drejtën time tek KMCAP Epror. I thashë se kam kontribute shoqërore për 29 vite. Që nga 2016 nuk punoj dot për shkak se jam dëmtuar rëndë edhe për shkak të punëve që kam kryer (ndërtim, hamall etj.) Problemi sipas përgjigjes së përfaqësuesve të Shërbimit Social Shtetëror, është se diagnoza ime nuk përfshihet tek diagnozat e mbrojtjes sociale. Diagnoza e ime mund të përfshihet tek skema e sigurimeve shoqërore, nga e cila nuk përfitoj dot sepse nuk kam kontribute 5 vitet e fundit. Kështu që pas 29 vite sigurime shoqërore jam sot pa asnjë të ardhur, fakt i padrejtë edhe sipas përfaqësuesve të Shërbimit Social Shtetëror, që e pranuan këtë ngërç ligjor si dhe faktin se është e pa drejtë që pas kaq shumë vitesh sigurime shoqërore nuk përfitoj asgjë tani që kam nevojë. Do doja unifikimin e listës së diagnozave ose heqjen e kushtit për kontribute shoqërore vitet e fundit dhe marrjen parasysh të viteve të punës dhe kontributeve shoqërore përgjatë gjithë jetës. Dua gjithashtu të shpreh shqetësimin edhe për faktin se dosja me dokumentacionin përkatës është mbajtur nga punonjësit e KMCAP të zonës sime (tek Iraniani, Bryli), të cilët nuk ma dorëzojnë atë pavarësisht kërkesave të mia të vazhdueshme. Bëj me dije se unë e kam kërkuar tërheqjen e dosjes, por nuk ma japin”.

Në këto kushte, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe unifikimin e listës së diagnozave ose heqjen e kushtit për kontribute shoqërore vitet e fundit duke marrë parasysh vitet e punës dhe kontributet shoqërore përgjatë gjithë jetës.

Gjithashtu kërkon nga Komisioneri, të administrojë dokumentacionin përkatës që i është mbajtur nga punonjësit e KMCAP (tek Iraniani, Brryli).

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar nga ana e ISSH-së dhe KMCAP-së, pasi këta të fundit me veprimet dhe mosveprimet e tyre e kanë përjashtuar nga e drejta për të përfituar nga skema e mbrojtjes sociale dhe përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar.

Ankuesi pretendon se shkak i diskriminimit është aftësia e kufizuar, pra, arsyeja për trajtimin e padrejtë dhe të pafavorshëm të cilit ai i është nënshtruar, në rastin konkret përjashtimi nga e drejta për të përfituar nga skema e mbrojtjes sociale dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, ka si shkak faktin që ankuesi është me aftësi të kufizuar.

Pala ankuese pavarësisht faktit që ka pretenduar përpara Komisionerit se është person me aftësi të kufizuara dhe ka aplikuar pranë KMCAP-së për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar, nuk ka depozituar asnjë provë apo fakt lidhur me të.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”. (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin

e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkakun e aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “Diskriminimit i drejtëpërdrejtë”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “Diskriminimit të tërthortë” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1

të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun IV, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, germa a) parashikon shprehimisht se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...”*.

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji. Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo

diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Neni 1, i ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i mbrojtur. Për sa më sipër, shkakut i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit dhe si i tillë, para pranimit për shqyrtim të ankesës së depozituar nga ankuesit, duhet vërtetuar së pari ligjshmëria e tij, si dhe së dyti duhet mbështetur provueshmëria e tij. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar, para pranimit për shqyrtim të ankesës së depozituar nga ankuesi, duhet vërtetuar dhe duhet mbështetur provueshmëria e tij. Në rastin konkret, ankuesi nuk ka depozituar asnjë provë apo fakt lidhur me provueshmërinë e shkakut të diskriminimit, si dhe nëse ai ka aplikuar pranë KMCAP-së për përfitimin e pagesës së invaliditetit.

Mbështetur në nenin 32/1/a, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, për një nga shkaqet e mbrojtura, siç parashikohet në këtë ligj.

Përveç sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se çështja e moskthimit të një përgjigjeje nga ana e KMCAP-së, në bazë të Ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë kontekst, rekomandohet që subjekti ankues të depozitojë ankesë pranë institucionit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b”, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet, pasi është e

papajftueshme me dispozitat e LMD, të ndryshuar dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja b), nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 79, datë 17.05.2023, të paraqitur nga A. J., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)

